



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Stalnoq Sekretara/Office of the Permanent Secretary

DATË/A:	23.012020
REFERENC-Ë:	20/389-1/ 72/DMMU
PËR/ZA/TO:	Kompaninë „Vinex” shpk, Viti
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Arben Çitaku, Sekretar i përgjithshëm i MMPH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Leje për eksport të mbeturinave



Sipas kërkesës së juaj me nr. prot. 389/20, të datës 22.01.2020, MMPH ka shqyrtuar kërkesën dhe ka vendosur si në vijim.

Me respekt!

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përhershëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the Permanent Secretary

Në bazë të nenit 56, paragrafi 56.2 dhe 56.10 të Ligjit për Mbeturina nr 04/L-060 dhe në bazë të nenit 5, 12 dhe 15 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2019, për Eksport, Import dhe Transit të Mbeturinave, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nxjerr këtë :

VENDIM

Aprovohet kërkesa e kompanisë „Vinex” shpk, Viti me nr. prot. 389/20, të datës 22.01.2020, për eksport të mbeturinave të zinkut me nr. të Katalogut Shtetëror të mbeturinave 17 04 04 për kompaninë importuese:

„HEPSEN KIMYA” San.ve Tic. LTD. Sti. 15 Temmuz Mh. Bahar Caddesi. Nurol Park Sitesi J Blok No: 43 Kat:15 D: 153-154 Gunesli, BAGCILAR, Stamboll/Turqi me nr.Notifikimi RKS 0009/20-389/20 .

A r s y e t i m

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), pas shqyrtimit të kërkesës me nr. prot. 389/20, të datës 22.01.2020 nga kompania „Vinex” shpk Viti, për eksport mbeturinave të zinkut, në sasi prej 100.000.00 kg ne total me nr. e Katalogut Shtetëror të Mbeturinave 17 04 04 me nr. Notifikimi RKS 0009/20-389/20,

Vlerëson se nga kompania janë prezantuar dokumentet dhe shënimet e nevojshme sipas nenit 5; 12 dhe 15 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2019, për Eksport, Import dhe Transit të Mbeturinave dhe sipas nenit 56, paragrafi 2, të Ligjit për Mbeturina nr. 04/L-060 andaj i lëshohet leja për eksport të mbeturinave.



Kompania „Vinex” shpk, Viti, është e obliguar të bëjë transportimin e mbeturinave duke iu përmbajtur kushteve të ADR dhe transportimi të bëhet nga kompania e licencuar për transportimin e mallrave.

Kompania „Vinex” shpk, Viti, është e obliguar ta njoftoj MMPH me shkrim, pas çdo realizimi të eksportit të mbeturinave në sasinë e lejuar për të cilën lëshohet Leja.

Leja është e vlefshme në kohëzgjatje prej (1) një viti nga data e lëshimit të saj.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë në afat kohor prej 30 ditësh nga dita e lëshimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr. 20/389/ZSP/ 63 /20,

datë: 23.01.2020

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. DMMU
3. Inspektoratit
4. Kabinetit të Ministrit
5. Arkivit të MMPH-së

Sekretar i Përgjithshëm


Arben Çitaku



Faqe 3 nga 3